




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E MITROVICËS
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqës Ekipi, *Igballe Halili* dhe Anëtarëve, *Arnisa Aliu* dhe *Abdurrahmon Bërbatovci*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA	33
Shtojca II: Letër konfirmimi	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet e buxhetuara gabimisht në vlerë totale 118,763€ dhe shpenzimet, të cilat nuk ishin buxhetuar në vlerë 189,390€ (përmes vendimeve gjyqësore 186,754€) ishin shpenzuar në kategori ekonomike jo adekuate;
- Komuna ka shënuar progres në evidentimin e pronave, por ende nuk ka arritur t'i vlerësoj dhe t'i regjistrojë të gjitha tokat dhe objektet në regjistrin e pasurisë; dhe
- Vlerat e Llogarive të arkëtueshme të drejtorive komunale me ato të shpalosura në PFV tregojnë diferencë në vlerë totale prej 589,295€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi. Çështjet e theksuara në opinionin e auditimit ishin për shkak se klasifikimi i disa shpenzimeve nuk ishte në kategori adekuate si dhe llogaritë e arkëtueshme dhe pasuritë nuk ishin prezentuar saktë.

Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve për vitin 2019 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih theksimin e çështjes në opinionin e auditimit).

Menaxhimi financiar dhe Kontrolli- edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, përfshirë të hyrat, shpenzimet, obligimet, të arkëtueshmet si dhe pasuritë jo financiare.

Kryetari duhet të sigurohet se është kryer një vlerësim i detajuar në fushat brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për përsëritjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih kapitullin 3).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien dhe raportimin menaxherial duhet të përmirësohen.

Kryetari duhet të sigurohet se çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithëshme duhet të adresohen me një përgjegjësi dhe kujdes të shtuar (shih kapitullin 4).

Procesi i veprimeve për hartimin e planit të veprimit, rekomandimet kyçe nuk po adresohen siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.

Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/ progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih kapitullin 5).

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

- Pagesat të cilat janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht në kategori ekonomike jo adekuate:
 - pagesat në vlerë totale 113,956€¹, të cilat i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale;

¹ Pesë pagesa "Largimi i deponive të egra" në vlerë totale 73,750€; dy pagesa "Ndërtimi dhe mirëmbajta e varrezave" në vlerë 25,263€; dhe një pagesë "Pajisje mjekësore në vlerë 14,942€".

- pagesat për "Intervenimin emergjent për pastrim e rrugëve në fshatin Shupkove" në vlerë totale 2,933€ janë ekzekutuar nga kodi i subvencioneve dhe transfereve, ndërsa i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- pagesa për "Subvencionimin e bletarëve me koshere dhe pajisje për bletë "në vlerë 1,874€, ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale, ndërsa i takon kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.
- Pagesat të cilat nuk janë buxhetuar dhe janë shpenzuar gabimisht, në kategori ekonomike jo adekuate:
 - pagesa në vlerë totale 16,035€ (përmes vendimeve gjyqësore), të cilat i përkasin pesë pagave përcjellëse të mësimdhënësve me rastin e pensionimit, janë bërë nga kategoritë mallra dhe shërbime dhe investime kapitale;
 - pesë pagesat në vlerë totale 170,719€ (përmes vendimeve gjyqësore), të cilat i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime, janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
 - pagesa në vlerë 2,636€ për "Furnizim me gypa", ishte bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa i përket kategorisë së investimeve kapitale.
- Komuna ka bërë progres në identifikimin e pronave komunale, por edhe më tutje, nuk ka arritur të bëjë vlerësimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë në regjistrat e SIMFK-së (tokat dhe objektet), në mungesë ekspertëve për vlerësimin e pasurive; dhe
- Të dhënat për llogaritë e arkëtueshme nga disa drejtori² regjistrohen në mënyrë manuale dhe barten nga viti në vit. Në mungesë të një softueri dhe kujdesit jo të duhur për regjistrimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme nga disa drejtori, janë vërejtur diferenca në mes të regjistrave të brendshme dhe pasqyrave financiare vjetore në vlerë 230,853€. Ndërsa llogaritë e arkëtueshme, për mbeturina dhe ekonomi familjare ishin nënvlerësuar për 358,442€.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Në vitin 2017 ishte bërë shlyerja e llogarive të arkëtueshme për taksat e ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve për 1,587,196€ (nga 3,270,000€ në 1,682,804€). Kjo çështje nuk ishte shqyrtuar në Kuvendin Komunal, as në vitin 2018 dhe nuk ishte shpalosur në PFV-të. Sipas komunës, shlyerja ishte si pasojë e largimit të bizneseve që kanë të bëjnë me: largimin e bizneseve në komunën e Mitrovicës Veriore, largimin e disa bizneseve që kanë fituar me vendime gjyqësore dhe për shkak të përdorimit të një softueri të vjetër i cili ka përlllogaritur edhe bizneset pasive, e disa nga të cilat nuk ekzistojnë fare. Megjithatë, komuna nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë për shlyerje apo shqyrtim në Kuvendin Komunal.

² "Drejtorja e planifikimit dhe urbanizmit; "Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport"; "Drejtorja për gjeodezi kadastër dhe Pronë; dhe "Drejtorja e Inspektionit".

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Mitrovicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 (Shpenzimet Publike) dhe 02/2013 (Menaxhimi i pasurisë);
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë: raportet tremujore, raportet e faturave të papaguara, planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkuara publike.

Nga aspekti i cilësisë, draft PFV-të fillestare kanë pas nevojë të korrigojen për shkak se përmbanin disa gabime dhe mangësi informatash. Ato janë korrigjuar, me përjashtim të çështjeve të pasurive, llogarive të arkëtueshme dhe keq klasifikimit për të cilat çështje ne e kemi theksuar opinionin. Për më shumë, shih nënkapitullin 2.1 Opinioni i auditimit. Përpos çështjeve të theksuara të opinionit i auditimit ne kemi identifikuar gabime edhe të shpalosja e obligimeve, faturat e pranuar në janar të vitit 2019, e që i takojnë obligimeve të vitit 2018 në katër raste³ në vlerë 11,722€ nuk ishin shpalosur në PFV-të e 2018. Ndërsa shpalosja e pasurive jo financiare, ishte e bërë në vlerën bruto të tyre duke mos aplikuar zhvlerësimin e akumuluar. Për më tutje, një avancë i mbetur i hapur që nga viti 2015 në vlerë 3,215€, nuk ishte shpalosur në PFV-të.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrta e Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve të korrigjuara në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën, të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike. Po ashtu, të konsideroj si prioritet çështjen e menaxhimit të llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimit të pasurisë, përkatësisht shpalosjen e plotë të tyre dhe çështjeve tjera, e cila do të reflektohen drejt edhe në paraqitjen e PFV.

³ "Dreka e fund vitit me punëtorët e KK" në vlerë 2,550€; "Fshirja dhe larja e rrugëve lokale" në vlerë 5,203€; "Karburante për vetura 960€"; "Naftë për ngrohje" në vlerë 3,009€.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit dhe i shpenzimeve për kategori ekonomike, përfshirë klasifikimin adekuat të shpenzimeve, menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i burimeve njerëzore. Ndërsa për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në saktësinë e tyre, si dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe. Përveç kësaj nevojitet një përqendrim më i shtuar i komunës në parandalimin e ekzekutimit të pagesave direkte nga thesari dhe pagesave përmes vendimeve gjyqësore.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁴	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	18,446,443	19,869,098	19,067,588	16,682,266	16,285,762
Granti i Qeverisë -Buxheti	15,973,330	16,800,927	16,627,843	14,471,605	13,980,967
Të bartura nga viti paraprak ⁵		323,793	317,997	328,678	291,289
Të hyrat vetjake ⁶	2,445,366	2,445,366	1,927,625	1,759,351	1,755,799
Donacionet e brendshme	-	112,532	79,767	78,665	175,152
Donacionet e jashtme	-	125,340	114,356	43,967	82,555
Financimi nga huamarrja	27,747	61,140	-	-	-

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁶ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,422,655€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 323,793€, donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 237,872€, si dhe nga huamarrjet për drejtorinë e arsimit në vlerë 33,392€ dhe ndryshimeve me vendime të Qeverisë së Kosovës 827,597€. Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 96%, të buxhetit final ose 19,067,588€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	18,446,443	19,869,098	19,067,588	16,682,266	16,285,762
Pagat dhe Mëditjet	11,836,170	11,965,136	11,906,445	11,338,652	11,485,848
Mallrat dhe Shërbimet	1,969,150	2,454,498	2,351,120	1,201,215	1,337,968
Shërbimet Komunale	465,000	480,000	460,597	474,854	354,108
Subvencionet dhe Transferet	545,043	744,704	723,730	537,369	589,308
Investimet Kapitale	3,631,080	4,224,760	3,625,696	3,130,176	2,518,530

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Për kategorinë paga dhe mëditje, kishte rritje të buxhetit në vlerë 128,966€, nga të hyrat e bartura në vlerë 14,000€, donacionet e jashtme "Save and Children" në vlerë 7,811€ si dhe rritja me vendim të Qeverisë në vlerë 107,155€. Rritja nga grandit qeveritar ishte me që në fund vit, disa punëtorë nga drejtoria e arsimit, të cilët ishin jashtë listës së pagave, janë përfshirë në listat e pagave;
- Te kategoria mallra dhe shërbime kishte rritje totale në vlerë 485,348€, nga grantet Qeveritare⁷ 205,324€, nga të hyrat e bartura në vlerë 222,693€, donacionet e brendshme dhe të jashtme në vlerë 37,271€, nga huamarrjet 36,684€, si dhe zvogëlim prej shkurtimeve buxhetore 16,624€. Ndërsa buxheti për komunalit ishte rritur nga të hyrat e bartura në vlerë 15,000€;
- Te subvencionet dhe transferet kishte rritje për 199,660€, nga grandit qeveritarë 145,000€ (Vendim i Qeverisë nr.04/74 në fund vit për kursime, ndarje dhe transfere), nga të hyrat e bartura në vlerë 30,000€ dhe si dhe grandeve dhe donacioneve të brendshme prej 24,660€; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale kishte rritje në vlerë totale 593,680€. Rritja e buxhetit ishte përmes vendimit të Qeverisë nr.13/56 për projektin "Ngritja e monumentit kushtuar Dëshmorit të Kombit Adem Jashari" në vlerë 88,500€, Vendimit të Qeverisë nr.10/75 për projektin "Autoanalizator Hematologjik-Biokimik (Pajisje Speciale Mjekësorë) në vlerë

⁷ Vendimi i Qeverisë nr.10/75 nga shpenzimet e paparashikuara në vlerë 100,000€ dhe vendimi i Qeverisë nr.04/74 në fund vit për kursime, ndarje dhe transfere në vlerë 105,324€.

100,000€ dhe Vendimit të Qeverisë nr.04/74 në vlerë 181,618€. Ndërsa, nga të hyrat e bartura në vlerë 42,100€, nga donacionet e jashtme dhe të brendshme në vlerë 168,089€, nga huamarrjet në vlerë 24,455€ dhe kishte zvogëlim nga kursimet buxhetore në vlerë 11,082€.

Çështja B2^s - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Gjetja Edhe pse buxheti në tërësi është realizuar në masën 96%, në kontest të performancës situata tregon se planifikimi dhe shpenzimi ishte mjaft sfidues. Gjatë vitit është shfaqur nevoja për disa përshtatje buxhetore, duke shfrytëzuar mjetet e mbetura nëpër drejtori, me qëllim të realizimit të pagesave, përkatësisht shlyerjen e obligimeve. Për një përshtatje të tillë kishin ndikuar edhe pagesat direkte, të ekzekutuara nga thesari në vlerë 71,760€ dhe pagesat përmes vendimeve gjyqësore në vlerë 1,053,387€.

Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja fillestare e buxhetit nuk është bërë si duhet. Mos planifikimi i mirëfilltë dhe përshtatjet e tilla, kishin shkaktuar klasifikim jo adekuat të kategorive ekonomike (nënkaptulli 2.1).

Rreziku Planifikimi fillestar jo i duhur dhe mos kryerja e obligimeve me kohë rrisin rrezikun që objektivat e përcaktuara të komunës mos të arrihen. Po ashtu, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kode ekonomike ndikon në paraqitjen jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Ndërsa, planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2018 ishin në vlerë 1,998,186€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, taksat administrative, etj. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e policisë dhe gjobat dhe Agjencia e Pyjeve në vlerë 278,306.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,445,366	2,445,366	1,998,186	1,951,350	1,995,219
Totali	2,445,366	2,445,366	1,998,186	1,951,350	1,995,219

^s Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Për vitin 2018, komuna, ka inkasuar 82% të të hyrave të planifikuara. Me një rritje prej 2% krahasuar me vitin e kaluar. Mirëpo, nëse përfshijmë edhe dënimet e trafikut, gjobat e gjykatave si dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve në vlerë totale 278,306€, do të thotë ka një realizim prej 93%. Komuna kishte përfshirë në planifikim këto të hyra.

Çështja C1 - Sfidat në menaxhimin e të hyrave

Gjetja Procesi i menaxhimit të mbeturinave komunale i rregulluar me "Rregulloren nr.03/2016 për menaxhimin e mbeturinave", nuk korrespondon me marrëveshjen për shërbime primare të menaxhimit të mbeturinave në mes të Komunës së Mitrovicës dhe KRM "UNITETI" SHA, e cila mbështetet në kontratën kornizë të vitit 2015 -2018. Sipas marrëveshjes në mes të Komunës dhe KRM Uniteti, ishte cekur që arkëtimi i mjeteve të bëhet nga inkasantët e KRM-së Uniteti.

Po ashtu, sipas rregullores, taksat mbi mbeturina, faturohet dhe inkasohet nga komuna dhe pagesa e taksës mbi mbeturinat në shumë deri në 10€ bëhet në arkën e komunës në qendrën e shërbimit me qytetarë, kurse në shumën mbi 10€ të bëhet në bankë.

Arkëtimi i të hyrave bëhet në sektorin për menaxhimin e mbeturinave, përmes punëtorëve me kontratë nga Unitetit (inkasantë dhe tre kontabilistë), derisa edhe kontabilistët e cekur kryejnë punën si arkëtarë. Në anën tjetër, në këtë proces, vetëm një punëtor është nga komuna, puna aktuale e të cilit është si arkëtar kryesorë, derisa sipas kontratës dhe përshkrimit të detyrave është zyrtar i mbeturinave.

Si rezultat i një menaxhimi dhe sistemit jo adekuat për menaxhimin e të hyrave nga ekonomitë familjare dhe bizneset dhe si pasojë e bazës jo adekuate të rregullave të brendshme, ka diferenca në regjistrin e të dhënave. Të dhënat në data bazën e ofruar janë më të larta në krahasim me shënimet e Thesarit në vlerë prej 50,951€ (te kodi ekonomikë menaxhimi i mbeturinave 50423). Për më tutje, nga gjashtë raste, në një rast, kemi verifikuar se kishte keq klasifikim në vlerë 1,846€, ku të hyrat për leje mjedisore ishin regjistruar në kodin për menaxhimin e mbeturinave. Diferenca e tillë dhe klasifikimi jo i duhur i kodeve ekonomike nuk na jep siguri se mbahen evidenca të duhura për taksapaguesit.

Rreziku Dobësitë në menaxhimin e të hyrave përkatësisht rregullores për mbeturina, mund të krijojë mundësi të keq interpretimeve. Angazhimi i shumicës së punëtorëve nga ndërmarrja publike e unitetit në sektorin për menaxhimin e mbeturinave mund të rezultojë me monitorim të dobët dhe mos marrje të duhur të përgjegjësisë për gabimet e ndodhura.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të sigurojë një sistem të përshtatshëm të regjistrimit, për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Procesi i menaxhimit të të hyrave nga mbeturinat komunale duhet të rishqyrtohet në rregullore, në mënyrë që të dihen qartë të drejtat dhe obligimet e palëve dhe ndarja e detyrave. Po ashtu t'i kushtojë kujdes të shtuar kontrolleve të brendshme sa i përket arkëtimit të saktë të të hyrave nga ky sektorë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave. Gjate vitit 2018 janë shpenzuar 11,906,445€ për paga dhe shtesa, me një realizim prej 99% e asaj që është planifikuar të realizohet.

Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrolli i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, si dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Çështja B3 - Marrëveshjet kontraktuale dhe angazhimi i stafit në afate të caktuara

Gjetja Komuna, kishte angazhuar 46 punëtorë me marrëveshje për shërbime të veçanta, duke mos aplikuar procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (LSHV) neni 12 pika 4. Për me tepër në tre raste të angazhuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta ishin për pozita të rregullta dhe nuk kishin të bënin me punë specifike.

Mos aplikimi i procedurave të thjeshtësuar të rekrutimit ishte si pasojë mos zbatimit të kërkesave ligjore nga komuna. Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur me që drejtoritë kanë bërë kërkesë për rekrutim pa procedura të thjeshtësuar.

Rreziku Mungesë e konkurrencës së mirëfilltë, rritë rrezikun që të angazhohen personat jo kompetent për pozitat përkatëse. Mbulimi i pozitave të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme, rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore. Po ashtu, në rast të punësuarve me marrëveshje dhe shërbime të veçanta të aplikojë procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 2,926,011€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 2,811,717€ apo 96%. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja B4 – Kontratat jashtë planit të prokurimit

- Gjetja** Dy kontrata të nënshkruara gjatë vitit 2018 në vlerë 108,477€⁹ në mungesë të parashikimit në planin e prokurimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit ishte bërë pa marrë aprovim në AQP siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik (neni 8 dhe 9). Planifikimi jo adekuat ishte shkaktar i lidhjes së kontratës jashtë planit të prokurimit.
- Rreziku** Lidhja e kontratave jashtë planit të prokurimit, rrezikon realizimin e kontratave që janë planifikuar dhe ndryshimin në prioritet, apo edhe hyrjen në obligime pa mbështetje buxhetore.
- Rekomandimi B4** Kryetari, duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore.

Çështja A1 - Ndarja jo e duhur e detyrave

- Gjetja** Në udhëzuesin operativ të prokurimit publik, neni 62.3 parimet e ndarjes së detyrave, citon se zyrtarët të cilët kanë qenë anëtarë të komisionit të vlerësimit nuk mund të caktohen menaxherë të projekteve. Nga nëntë (9) raste, në gjashtë (6) raste, njëri nga tre anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, ishte caktuar edhe si menaxherë i kontratës.
- Kjo kishte ndodhur, si pasojë e mos zbatimit të udhëzuesit operativë së prokurimit publik për ndarjen e detyrave. Sipas zyrtarëve, ndarja jo e duhur e detyrave ishte bërë për shkak të mungesës së stafit.
- Rreziku** Mos zbatimi i rregullave dhe udhëzimeve të prokurimit publik, rrit rrezikun e shkeljes së parimeve të ndarjes së duhur të detyrave për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.
- Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.

⁹ Subvencionimi i kamatave nga komuna për kredi për fermerët në vlerë 98,892€ dhe Furnizim me koshere të bletëve dhe pajisje tjera ndihmesë në vlerë 9,585€.

Çështja B5 - Pranimi jo i rregullt i furnizimeve

- Gjetja** Sipas Rregullores nr.01/2013 (neni 23, pika 1), për pranimin e furnizimeve, parashihet formimi i komisionit të caktuar. Nga 41 pagesa të testuara, në tre pagesa në vlerë 34,671¹⁰€, pranimi i furnizimeve ishte bërë vetëm nga depoisti.
- Kjo kishte ndodh për shkak të neglizhencës nga ana e komunës për formimin e komisionit të caktuar për pranimin dhe furnizimin e mallrave.
- Rreziku** Pranimi i furnizimeve pa komision të pranimit, rrit rrezikun që të pranohen furnizime të cilësisë jo të mirë dhe në kundërshtim me kushtet e kontraktuara.
- Rekomandimi B5** Kryetari duhet të bëjë një rishikim të brendshëm, për të përcaktuar vendimet lidhur me formimin e komisionit përkatës për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 744,704€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 723,730€ apo 97%. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me shpenzimet e varrimit, bursa për student, mbështetje të fermerëve, si dhe personave fizik si përfitues individual në gjendje të vështirë social-ekonomike.

Komuna kishte subvencionuar fermerët me kamata, për vitin e parë (2018), në njoftimin publik, nuk kishte kritere. Megjithatë në vitin e dytë (2019) ishte zbatuar rekomandimi, i dhënë gjatë kohës audituese.

Çështja A2 - Mos respektimi i kritereve për dhënien e subvencioneve

- Gjetja** Për subvencionin me "Sera me sipërfaqe nga 200m² dhe 50m²" ishin përcaktuar kushtet dhe kriteret për përfitimin e serave¹¹. Sipas njoftimit, një ndër kriteret ishte që përfituesit të kenë tokë bujqësorë (prone e tij, ose të kontraktuar për shfrytëzim minimum 10 vite). Nga pagesa në vlerë 13,749€, kemi testuar katër përfitues, dy prej tyre, nuk kishin plotësuar kriterin, pasi që përfituesit, nuk kishin dëshmuar se tokat ishin në emër të tyre, ndonëse ishin përzgjedhur si të përgjegjshëm dhe ishin përfitues të subvencioneve.

Kjo kishte ndodhur për arsye se komisioni vlerësues nuk kishte respektuar kritere të njëjta për dhënien e subvencioneve, duke neglizhuar procesin mbi kriteret bazë.

¹⁰ "Furnizime për zyre" në vlerë 9,620€; "Furnizim me dokumente" në vlerë 5,380€; "Furnizime mjekësore" në vlerë 19,671€

¹¹ Sipas Rregullores së komunës nr. 11/2013 për subvencione dhe transfere

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të njëjta për të gjithë përfituesit mund të shpie në keq përdorim të qëllimit të subvencioneve, dhe njëkohësisht dëmton përfituesit tjerë potencial.

Rekomandimi A2 Kryetari, duhet të sigurojë se komisioni vlerësues përzgjedhë përfituesit në përputhje me rregullat dhe kriteret e vendosura në rregulloren për subvencione, në mënyrë që procesi të jetë në dobi të atyre që plotësojnë kriteret.

Çështja A3 - Sfidat në procedura për ndërtimin e objektit

Gjetja Komuna kishte subvencionuar “Organizatën komunale të pensionistëve dhe invalidëve të punës” në vlerë 145,000€, me vendim të Kuvendit Komunal, me qëllim të ndërtimit të një objekti për organizatën. Komuna nuk kishte lidhur një marrëveshje mirëkuptimi me OJQ-në e subvencionuar për të përcaktuar të drejtat dhe obligimet e palëve.

Deri në periudhën e auditimit (prill 2019) procedurat e nevojshme për ndërtimin e objektit, ende nuk kishin filluar, për shkak të kontestit gjyqësor për pronën-parcelat ku duhet të ndërtohet objekti. Sipas zyrtarëve të komunës dhe fletës poseduese, parcela ku do të ndërtohet objekti është pronë komunale, ndërsa organizata pretendon se parcela është në pronësi të saj dhe për këtë arsye kishte ripërtërirë, padinë ndaj komunës, në janar të vitit 2019. Si rezultat i kontesti gjyqësor, punimet ende nuk kishin filluar, përderisa mjetet financiare janë transferuar nga komuna tek organizata e lartpërmendur.

Rreziku Mos qartësimi i pronësisë dhe mos lidhja e një marrëveshje mirëkuptimi paraprake, rritë rrezikun që komuna nuk posedon mekanizma garantues së objekti do të ndërtohet dhe mjetet do të shpenzohen për qëllimet e caktuara.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të ketë në monitorim çështjen në kontest dhe që gjatë vitit 2019, paraprakisht të nënshkruaj marrëveshje mirëkuptimi me OJQ-në dhe t'i përcaktojë të drejtat dhe obligimet e palëve lidhur me subvencionin e dhënë, në mënyrë që mjetet që janë dhënë të jenë shfrytëzuar për qëllimin e dhënë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,224,760€, prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 3,625,696€ apo 86%, që kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale.

Çështja A4 - Tejkallim i shumës së planifikuar dhe ndërrim i projektit

Gjetja Sipas ligjit të buxhetit 2018, "Ndryshimet në shumat e alokuara për projektet ekzistuese, të prezantuara në tabelën 4.2, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal (KK).

Për rregullimin e rrugëve në fshatrat Melenicë, Maxherë, dhe Dedi, me buxhetin e vitit 2018 ishin paraparë të shpenzohen 50,000€, ndërsa vetëm për fshatin Maxherë për rregullimin e rrugëve, Voce Gimaj dhe Ilmi Cimili, ishin paguar 135,741€ duke tejkalluar vlerën e planifikuar. Këto mjete janë ndarë me vendim të kryetarit pa aprovim të Kuvendi Komunal (KK) nga projekti për ndërtimin e rrugëve në fshatin Kçiq 85,741€ dhe nga projekti ndërtimi i rrugëve në fshatin Bajgorë 50,000€, duke ndërprerë punimet në këto dy projekte me arsyetim se kontrata është tre vjeçare dhe punimet do të vazhdojnë në vitin 2019, pavarësisht ndarjes buxhetore për vitin 2018.

Shkak i kësaj ishte se ekzekutivi nuk e ka iniciuar kërkesën në Kuvendin Komunal për ndryshimin e shumave të alokuara për projektet ekzistuese, po ashtu njësi kërkuese nuk kishte bërë një planifikimin të duhur për projektin në fjale.

Rreziku Mos aprovimi i projekteve të reja, do të zvogëlojë zbatimin efektiv të planeve të parapara të shpenzimeve kapitale dhe pasqyrim të pasaktë të projekteve të realizuara brenda kategorisë së investimeve kapitale. Po ashtu, planifikimet e dobëta ndikojnë negativisht në aspektin buxhetorë të komunës, duke dëmtuar realizimin e projekteve tjera të planifikuara.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet siguroj që ndryshimet/ridestinimet në projektet kapitale të komunës të prezantuara në tabelën 4.2, të aprovohen paraprakisht në Kuvendin Komunal. Po ashtu të sigurojë që njësit kërkuese të kenë një planifikim real të projekteve, ashtu që mos të hyjnë në obligime pa pasur mjete buxhetore të mjaftueshme.

Çështja A5 - Shkurtimi afateve në procedurat e prokurimit

Gjetja Sipas Ligjit nr. 04/L-042 të prokurimit publik, neni 44 pika. 2.1 kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, afati për pranimin tenderëve duhet të jetë jo më pak se dyzet (40) ditë. Për "Ndërtimin e rrugës në fshatin Kovaqicë Loti i I-rë" në vlerë 948,393€, ishin zhvilluar procedurat e prokurimit për kontratë publike me vlerë të madhe, mirëpo nuk ishte zbatuar rregulla e përgjithshme për caktimin e afateve kohore për pranimin e tenderëve, afati kohorë për pranimin e tenderëve i dhënë nga komuna ishte 18 ditë.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e kontrollit të dobët në menaxhimin e procesit të prokurimit, duke neglizhuar kërkesat ligjore të prokurimit.

Rreziku Shkurtimi i afateve kohore për pranimin e tenderëve mund të jetë kohë e pamjaftueshme për të përgatitur dhe ofertuar, gjë që mund të ndikojë në diskriminimin e operatorëve tjerë për të ofertuar.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në zbatimin e procesit të prokurimit, ashtu që afatet kohore të parapara për dorëzimin e tenderëve të jenë sipas ligjit të prokurimit publik, në mënyrë që t'i jap kohë të mjaftueshme, të gjithë operatorëve ekonomike për të ofertuar.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Vlera neto e pasurive kapitale në PFV në fund të vitit 2018 është 28,600,220€

Çështja B6 - Sfidat në menaxhimin e pasurive jo financiare

Gjetja Komuna nuk ka arritur që t'i regjistrojë të gjitha pasuritë jo financiare në sistemin e-pasuria siç kërkohet me Rregulloren e MF nr.2/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Blerjet nën 1000€, gjatë vitit 2018 ishin 76,074€, ndërsa në sistemin e e-pasurisë ishin regjistruar vetëm 34,706€. Pjesën tjetër, të pasurive (41,368€) zyrtari i pasurisë i mban veçmas në formë të Excel, me ç'rast i regjistron sipas datës së blerjes, ndërsa nuk aplikon zhvlerësimin tek ato. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos regjistrimit të pasurive jo financiare nga zyrtari i depozitave në sistem. Po ashtu, komisioni i inventarizimit vjetorë, në mungesë të regjistrave të plotë të pasurive nën 1000€, nuk kishte arritur të bëjë krahasimet me regjistrat e pasurisë.

Për më tutje, gjatë verifikimit të regjistrat të e-pasurisë kemi identifikuar se shtatë llaptopë nuk ishin regjistruar në sistem me numra serik sipas rregullores MF - nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare (neni 6).

Sipas zyrtarëve komunal, shkak i këtyre parregullsive është mungesa e trajnimeve nga ana e Ministrisë së Administratës Publike për përdorimin e sistemit nga ana zyrtarëve përkatës. Mirëpo, kjo situatë ndikohet edhe nga kontrolli jo i duhur lidhur me zbatimin e rregullores për regjistrimin e pasurive.

Rreziku Mungesa e evidencave të sakta rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Mos evidenca e saktë, e pasurive me numra serik pamundëson identifikimin e pasurive.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore, varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Të arkëtueshmet

Komuna, në vitin 2018 ka deklaruar vlerën prej 8,417,880€ të llogarive të arkëtueshme, që krahasuar me vitin 2017 ishte 7,499,847€, pra borxhet ndaj komunës janë rritur për 918,033€. Vlerën më të madhe të këtyre e paraqesin të arkëtueshmet nga tatimi në pronë të cilat në fund të vitit fiskal arrinin në 5,784,413€, ku vetëm për vitin 2018 faturimi ishte prej 1,167,066€ ndërsa janë arkëtuar 625,435€ apo 53%.

Çështja B7 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna, nuk ka të vendosur procedura të brendshme për raportim dhe regjistrimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe aplikimin e procedurave për arkëtim. Rritja e të arkëtueshmeve nga viti në vit vazhdon të mbetet sfida për komunën.

Komuna kishte bërë përpjekje që të ketë një arkëtim më të mirë nga tatimpaguesit e tatimit në pronë, përmes një vendimi të kryetarit. Të gjithë tatimpaguesit ishin të obliguar të paguajnë një % të caktuara për borxhet e mbetura, megjithatë kjo nuk ishte reflektuar në pagesën e borxheve nga tatimpaguesit.

Gjatë auditimit të 12 kontratave për shfrytëzimin e pronës publike, identifikua se për shkak të mos pagesës mujore nga qiramarrësit sipas kontratës komuna nuk kishte arritur ta arkëtojë të hyrat për borxhin e akumuluar në vlerë totale 89,782€. Komuna aktualisht kishte shpërndarë njoftime tek qiramarrësit që nëse nuk paguajnë borxhin do të merren masa ndaj tyre.

Rreziku Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, mund t'i dekurajojnë tatimpaguesit tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Për më tutje, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 2,109,086€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Krahasuar me vitin e kaluar (1,425,216€), obligimet kanë shënuar rritje prej 683,870€.

Çështja B8 - Sfidat në menaxhimin e obligimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare nr.01/2013/MF- shpenzimi i parave publike (Neni 37- pika1) të gjitha faturat organizata buxhetore duhet ti paguaj brenda 30 dite.

Nga 104 mostra, në 14¹² raste, faturat në vlerë totale 383,681€, nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Vonesat ishin prej më shumë se tre muaj.

Shkak i mos pagesës me kohë ishte mungesa e mjeteve. Konstatimi është marrë nga zyrtarët komunal dhe nga auditimi dhe meqenëse kishte shumë pagesa përmes vendimeve gjyqësore, kjo ishte reflektuar edhe tek pagesa e faturave tjera, po ashtu edhe ndërrimi i projekteve.

Ndërsa detyrimet kontingjente, në fund të vitit 2018 ishin 3,380,800€, krahasuar me vitin e kaluar detyrimet kanë shënuar zvogëlim në vlerë 71,968€. Megjithatë, 13 raste të detyrimeve kontingjente, nuk ishin shpalosur në PFV-të të vitit 2018 edhe pse ishin pa vlerë financiare. Sipas avokatit të komunës (aktual), kjo është si pasojë e mungesës së arkivimit të lëndëve paraprake.

Rreziku Dështimet e pagesave ndaj furnitorëve në afatet ligjore gjatë vitit 2018, rritë rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraprak. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari që njëkohësisht reflektohet me kosto shtesë. Për më tutje, mos arkivimi i duhur i lëndëve për detyrime kontingjente, shkakton vështirësi në shpalosjen dhe gjendjen e saktë të tyre.

Rekomandimi B8 Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet dhe detyrimet kontingjente të mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve. Ndërsa, arkivimi i lëndëve për detyrimet kontingjente të jetë i saktë edhe në formë elektronike për verifikimin më të shpejtë të tyre.

¹² "Rregullim dhe riparim i rrugëve " në vlerë 67,394€; dy pagesa "Largimi i deponive të egra " në vlerë totale 65,009€; "Ndërtimi i rrugëve lokale " në vlerë 48,643€; "Ndërtim furnizim dhe de bllokimi" në vlerë 14,015€; "Ndërtim dhe mirëmbaje e varrezave " në vlerë 20,000€; tre pagesa "Zgjerim rrjetit ndriçimit publik " në vlerë totale 114,829€; "Mirëmbajtja dhe ngritja e sipërfaqeve të gjelbëruara" në vlerë 18,434€; "Shpenzimet për trajnimin " në vlerë 4,000€; "Furnizime mjekësore" në vlerë 19,671€; "Dhurata për vitin e ri" në vlerë 2,576€; "Shërbime të varrimit" në vlerë 9110€.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerri veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave (MF).

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkaptujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna këtë vit ka shënuar një progres duke përpiluar listën e rreziqeve në të cilën janë identifikuar pika të rëndësishme të rreziqeve me të cilat përballen departamentet përkatëse, si dhe kishte plotësuar dhe dërguar me kohë në MF pyetësin e vet-vlerësimit. Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë, ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Vëmendje e shtuar e menaxhmentit nevojitet në proceset për adresimin e rekomandimeve të auditimit, si dhe themelimi i komitetit të auditimit.

Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit socio-ekonomik lokal paraprake ishte valide deri në vitin 2017, për vitin 2018 ishte formuar një grup punues por ende nuk kishte arritur ta hartojë strategjinë.

Disa plane në sektorë të ndryshëm ishin të aprovuara nga Kuvendi Komunal: Plani Zhvillimor i Arsimit 2018-2022, Strategjia për kulturë dhe turizëm 2018-2022, Plani i integritetit për vitin 2017-2019 dhe Plani Komunal i Efiçencës së Energjisë 2014-2020.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe dy auditor. Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin paraparë të kryhen shtatë auditime. Po ashtu, kishte përgatitur raportin gjashtë mujor dhe vjetorë, të cilin e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese.

NjAB kishte planifikuar gjashtë auditime të cilat edhe i kishte përfunduar, ndërsa raportet kryesisht i takonin aktiviteteve të vitit 2017.

Çështja C2 - Mos themelimi i komitetit të auditimit

Gjetja Komiteti i auditimit (KA) gjatë vitit 2018 nuk ishte themeluar. Sipas zyrtarëve, mos themelimi i komitetit të auditimit ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka mundur të sigurojë staf të jashtëm për pjesëmarrje në KA siç parashihet me ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike nr.06/L-021 neni 20.

Rreziku Mos formimi i komitetit në pajtim me legjislacionin në fuqi, mund të ndikojë, që puna e auditorit të brendshëm të mos përcillet mjaftueshëm dhe procesi i zbatimit të rekomandimeve të jetë në nivel të ultë.

Rekomandimi C2 Kryetari, duhet të rishikoj emërimin e anëtarëve të komitetit të auditimit dhe të sigurohet se përzgjedhja e tyre është adekuate sipas kërkesave të ligjit dhe rregullores përkatëse, duke mënjanuar zyrtarët që mund të jenë subjekt i auditimit të brendshëm, në mënyrë të përmirësimit të kontrollit dhe menaxhimit financiar.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedojë raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet dhe ka hartuar listën e rreziqeve, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ende kërkojnë përmirësim.

Çështja C3 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

- Gjetja** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në menaxhimin e shpenzimeve duke i klasifikuar në kode adekuate, trajtimin e obligimeve të papaguara dhe pagesën e tyre me kohë, si dhe veprime konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.
- Rekomandimi C3** Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 ka rezultuar me 17 rekomandime. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Aktualisht komuna përmes ndihmës së një projekti të USAID-it është duke punuar rreth mundësisë së zbatimit të rekomandimeve. Kryetari i komunës kishte në rend të ditës raportin e auditimit për vitin 2017 në Asamblenë Komunale.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit tonë, nga 17 rekomandime të dhëna, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, tre (3) rekomandime ishin zbatuar pjesërisht, një (1) rekomandim i mbyllur i pazbatuar dhe tetë (8) rekomandimeve nuk ishin trajtuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	PFV	Kryetari, duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe çështjet kyçe (Keq klasifikimi i shpenzimeve, shpalosje jo e saktë e vlerës së pasurive dhe detyrimeve kontingjente në PFV). Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar dobësitë e paraqitura. Më tutje, Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Sa i përket klasifikimit të duhur të kodeve ekonomike, edhe këtë vit ishin evidente, me që kishte shumë përshtatje gjatë realizimit të buxheti, duke ndikuar edhe vendimet gjyqësore dhe pagesat. Komuna ka arritur progres në identifikimin e të gjitha pronave komunale, por nuk ka arritur t'i vlerësojë në mungesë të ekspertëve për vlerësimin e pasurive. Ndërsa, detyrimet kontingjente ishin shpalosur drejt, në përjashtim të 13 padive të cilat ishin pa vlerë financiare.	Rekomandim i pazbatuar.
2.	Procesi i buxhetit	Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Ndërsa, planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet	Mos ridestinimi i mjeteve dhe pagesat direkte dhe nga vendimet gjyqësore, mbesin prapë sfiduese për menaxhimin e buxhetit në komunë.	Rekomandim i pazbatuar.

		të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.		
3.	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë një sistem të përshtatshëm të regjistrimit, për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Procesi i menaxhimit të të hyrave nga mbeturinat komunale duhet të rishqyrtohet, në mënyrë që të respektohen ligjet/rregulloret në fuqi.	Në proces, mjetet e arkëtuara nga kjo e hyrë, gjegjësisht deponimi i mjeteve nga inkasantët bëhej çdo ditë sipas rregullës për të hyra. Sa i përket procesit të menaxhimit të të hyrave nga mbeturinat komunale, komuna ende nuk kishte bërë rishqyrtimin e legjislacionit në mënyrë që të respektohen ligjet/rregulloret në fuqi.	Rekomandim pjesërisht zbatuar.
4.		Kryetari, duhet të ndërmarr masat që sa më parë t'i pajisë qiramarrësit me kontrata në mënyrë që të kenë bazë ligjore të shfrytëzimit të të hyrave nga pronat komunale.	Komuna kishte ndërmarrë veprime që shfrytëzuesve të pronave t'i ripërtërihen kontratat, ndërsa për ata qiramarrës të cilët nuk i plotësojnë kriteret të largohen nga prona e shfrytëzuar; pas këtij veprimi çështjet ishin në proces gjyqësor.	Rekomandim zbatuar.
5.		Kryetari, duhet të sigurojë se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashihet ligji, në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.	Komuna këtë vit kishte arritët nga 20,589 prona të verifikojë 13,027 prona, sipas ligjit të ri të tatimit në pronë, komuna ka arritur ta bëjë verifikimin e pronave.	Rekomandim zbatuar.
6.	Pagat dhe shtesat	Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore. Po ashtu, në rast të punësuarve me marrëveshje dhe shërbime të veçanta të aplikojë procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.	Gjate ekzekutimit të auditimit konstatuam se 46 raste kontratat për marrëveshje me shërbime të veçanta kishin shkuar pa procedura të thjeshtuara të rekrutimit ku tre prej tyre ishin pozita që nuk ishin për pune specifike.	Rekomandim zbatuar.
7.	Menaxhimi i personelit	Kryetari, duhet të sigurohet se po respektohen procedurat, gjatë avancimit në karrierë të punësuarve, për t'i dhënë mundësi të barabarta për konkurrin të gjithëve kandidatëve potencial.	Gjatë auditimit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	Rekomandim zbatuar.

		Procedurat e tilla mundësojnë përzgjedhje më meritore.		
8.	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari, duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore.	Edhe këtë vit dy kontrata të nënshkruara, nuk ishin parapare në planin e prokurimit.	Rekomandim i pazbatuar.
9.		Kryetari, duhet të bëjë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar vendimet lidhur me formimin e komisionit përkatës për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.	Gjatë auditimit kemi vrenjtur se në tre raste, furnizimet ishin pranuar pa komision.	Rekomandim i pazbatuar.
10.		Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i hapjes dhe vlerësimit të tenderit është përcjellë me monitorim të duhur nga ana e komisionit dhe zyrtarit të prokurimit duke konfirmuar formalisht tërë procesin konform kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik.	Gjatë auditimit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
11.	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se për të gjitha kontratat të emërohen menaxherët, të cilët duhet të përgatisin dhe nënshkruajnë planin për menaxhimin e kontratës konform kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik.	Gjatë auditimit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
12.	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.	Edhe këtë vit, e kemi gjendur një jo të gjitha pasuritë jo financiare regjistruar në programin e e-pasurisë.	Rekomandim i pazbatuar.
13.	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që	Ky rekomandim po përsëritet nga viti i kaluar me që llogarite e arkëtueshme vit pas viti po rriten.	Rekomandim i pazbatuar.

		të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.		
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtoj obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre, si dhe të caktoj politika konkrete për parandalimin e hyrjeve në obligime të reja. Po ashtu t'i kryej obligimet me kohë sipas afatit të paraparë ligjor.	Gjatë testimit të obligimeve vrejtim se faturat nuk paguhen sipas afatit ligjore, si dhe një rritje të konsiderueshme të obligimeve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.	Rekomandim pazbatuar.
15.	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari, duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të përpilohet me kohë, të monitorohet në vazhdimësi dhe të raportohet në baza të rregullta tremujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		Rekomandim mbyllur.
16.	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari, duhet të rishikoj emërimin e anëtarëve të komitetit të auditimit dhe të sigurohet se përzgjedhja e tyre është adekuate sipas kërkesave të rregullores përkatëse, duke mënjanuar zyrtarët që mund të jenë subjekt i auditimit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me hartimin e planeve të veprimit si dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit nga NjAB.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime, dhe kishte hartuar planin e veprimit si dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Ndërsa nuk kishte arritur ta themeloi komitetin e auditimit.	Rekomandim pjesërisht zbatuar.
17.	Raportimi menaxhrial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.	Në proces, menaxhimi i kontrolleve ende duhet të forcohet tek shpenzimet dhe te të hyrat, fushën e prokurimit dhe kryerjen e obligimeve me kohë, ndërsa sa i përket menaxhimit të rrezikut komuna kishte hartuar listën e rreziqeve.	Rekomandim pjesërisht zbatuar.

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1.	PFV	Kryetari duhet të siguroj që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën, të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike. Po ashtu, të konsideroj si prioritet çështjen e menaxhimit të llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimit të pasurisë, përkatësisht shpalljen e plotë të tyre dhe çështjeve tjera, e cila do të reflektohen drejt edhe në paraqitjen e PVF.
2.	Realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Ndërsa, planifikimi dhe buxheti i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.
3.	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë një sistem të përshtatshëm të regjistrimit, për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Procesi i menaxhimit të të hyrave nga mbeturinat komunale duhet të rishqyrtohet në rregullore, në mënyrë që të dihen qartë të drejtat dhe obligimet e palëve dhe ndarja e detyrave. Po ashtu t'i kushtojë kujdes të shtuar kontrolleve të brendshme sa i përket arkëtimit të saktë të të hyrave nga ky sektorë.
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërliken me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore. Po ashtu, në rast të punësuarve me marrëveshje dhe shërbime të veçanta të aplikojë procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.
5.	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari, duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore.
6.		Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.
7.		Kryetari duhet të bëjë një rishikim të brendshëm, për të përcaktuar vendimet lidhur me formimin e komisionit përkatës për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.
8.	Subvencione dhe transfere	Kryetari, duhet të sigurojë se komisioni vlerësues përzgjedhë përfituesit në përputhje me rregullat dhe kriteret e vendosura në rregulloren për subvencione, në mënyrë që procesi të jetë në dobi të atyre që plotësojnë kriteret.
9.		Kryetari duhet të ketë në monitorim çështjen në kontest dhe që gjatë vitit 2019, paraprakisht të nënshkruaj marrëveshje mirëkuptimi me OJQ-në dhe t'i përcaktojë të drejtat dhe obligimet e palëve lidhur me subvencionin e dhënë, në mënyrë që mjetet që janë dhënë të jenë shfrytëzuar për qëllimin e dhënë.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet siguroj që ndryshimet/ridestinimet në projektet kapitale të komunës të prezantuara në tabelën 4.2, të aprovohen paraprakisht në Kuvendin Komunal. Po ashtu të sigurojë që njësit kërkuese të kenë një planifikim real të projekteve, ashtu që mos të hyjnë në obligime pa pasur mjete buxhetore të mjaftueshme.

11.		Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në zbatimin e procesit të prokurimit, ashtu q afatet kohore të parapara për dorëzimin e tenderëve të jenë sipas ligjit të prokurim publik, në mënyrë që t'i jap kohë të mjaftueshme, të gjithë operatorëve ekonomikë për ofertuar.
12.	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiar. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohe përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.
13.	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që t ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligim dhe detyrimet kontingjente të mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendos prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara ap vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 3 ditëve. Ndërsa, arkivimi i lëndëve për detyrimet kontingjente të jetë i saktë dhe në form elektronike për verifikimin më të shpejtë të tyre.
15.	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari, duhet të rishikoj emërimin e anëtarëve të komitetit të auditimit dhe të siguroh se përzgjedhja e tyre është adekuate sipas kërkesave të ligjit dhe rregullores përkatës duke mënjanuar zyrtarët që mund të jenë subjekt i auditimit të brendshëm, në mënyrë përmirësimit të kontrollit dhe menaxhimit financiar.
16.	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportim financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështet menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një opinion të kualifikuar nëse: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një opinion të kundërt nëse, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë mohim të opinionit nëse, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç 'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS


Republika Kosova – Republic of Kosoves

Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

ZYRA E KRYETARIT

LETËR E KONFIRMIMIT



Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Draft-Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,


Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar Draft-Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 . (në tekstin e mëtejme “ Raporti ”) ;
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit ; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një Plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Agim Bahtiri

Kryetar i Komunës së Mitrovicës,

Data: 22. Maj 2019, Mitrovicë



POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2018 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog pisma, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Mitrovica za godinu završno sa 31 decembrom 2018 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- se slažem sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar u vezi sa sadržajem izveštaja; i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Agim Bahtiri

Gradoćelnik Opštine Mitrovica,

Datum: 22. Maj.2019, Mitrovica,